

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik, Dep. Ekonomiksit
Titulli i lëndës:	Historia e Mendimit Ekonomik
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri I
Numri i orëve në javë:	2
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass.Dr. Luljeta Elezaj
Detajet kontaktuese:	Email. luljeta.elezaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	Historia e mendimit ekonomik studion shkollat kryesore në historinë e zhvillimit të mendimit ekonomik. Materia e cila do të shtjellohet përfshinë historinë e mendimit ekonomik dhe kohërat e hershme deri në kohët modern, për të kuptuar ndërveprimet e dijetarëve/ekonomistëve dhe ndikimin e tyre në shoqëri. Temat që do të trajtohen përfshijnë: Mendimin e hershëm ekonomik, mendimin ekonomik prej shekullit të mesëm e gjerë në shekullin XX, rrjedhat kryesore të teorisë bashkëkohore ekonomike dhe çështjet e ndryshme të prodhimit, veprimt të mekanizmit të tregut dhe teoritë ekonomike.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës Historia e Mendimit ekonomik është që rrisë njohuritë e studentëve për shkollat kryesore në historinë e zhvillimit të mendimit ekonomik, rrjedhat kryesore të teorisë ekonomike dhe ndikimi i tyre në shoqëri.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mësojnë për ekonomistët dhe kontribuesit kryesor në historinë e mendimit ekonomik. 2. Fillojnë të mendojnë për aplikimin e mendimeve/ideve ekonomike në situata të caktuara. 3. Të ngrisin njohuritë mbi rrjedhen e zhvillimit të mendimit ekonomik në kohërat e hershme dhe ato moderne.
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të	

nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume,seminare	1	15	15
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	10	30
Projektet,prezentimet ,etj	1	15	15
Totali			180
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Studentët marrin pjesë në ligjerata dhe ushtrime. Pas çdo njësie jepen detyra për përgatitjen e seminareve, të cilat diskutohen në javën në vijim. Mësimdhënia do të përqendrohet në pjesëmarrjen aktive të studentëve në procesin e mësimin, me prezantime individuale dhe grupore, me komente lidhur rrjedhën e zhvillimit ekonomik dhe mundësinë e aplikimit të ideve/mendimeve ekonomike në kohërat e sotme.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi në këtë lëndë bazohet në tri teste, në provimin përfundimtar dhe në seminare.Gjatë vitit do të organizohen 3 teste, në provimin përfundimtar si dhe në seminare. Secili test duhet të kalohet së paku 51 % të poenave total për të kaluar komplet provimin. Nota përfundimtare llogaritet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Poenat në test: 40% - Poenat në provim: 50% - Poenat nga seminari: 10% 		
Literatura			
Literatura bazë:	Dr. Sinan Ademaj (1996) : Historia e Mendimit Ekonomik		

Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Denis Henri (2010) : Historia e Mendimit Ekonomik, Shtëpia Botuese Papyrus, Tiranë. Ky tekst është përkthyer në shqip nga Fatmir Guri. - Rondo Cameron-Larry Neal (2003): Historia e ekonomisë botërore, Botim i katërt.
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Ligjeratë hyrëse: Historia e mendimit Ekonomik si disiplinë shkencore Lënda e studimit dhe klisifikimi i mendimit ekonomik Raporti ndaj shkencave të tjera
<i>Java e dytë:</i>	Mendimi i hershëm ekonomik (mendimi ekonomik i epokës së skllavërisë, Greqisë Antike, romës së lashtë dhe epokës së feudalizmit)
<i>Java e tretë:</i>	Merkantilizmi Idetë merkantiliste Përfaqësuesit e merkantilizmit
<i>Java e katërt:</i>	Fiziokratizmi Përfaqësuesit e fiziokratizmit
<i>Java e pestë:</i>	Fillet e ekonomisë politike klasike Përfaqësuesit e politikës klasike
<i>Java e gjashtë:</i>	Sistemi i teorisë ekonomike të Adam Smithit Jeta dhe veprimtaria e Adam Smithit Formimi i teorisë së Smithit
<i>Java e shtatë:</i>	Sistemi i teorisë ekonomike të David Rikardos Teoria e Vlerës Modeli i rritjes të Rikardoja
<i>Java e tetë:</i>	Zhvillimi i mëtejshëm i Ekonomisë Klasikë në Francë dhe Angli Pikëpamjet e përgjithshme dhe pjesëmarrësit
<i>Java e nëntë:</i>	Formimi i Shkollës Historike të Mendimit Ekonomik Përfaqësuesit kryesor
<i>Java e dhjetë:</i>	Rrjedha kryesore e teorisë bashkëkohore ekonomike Analiza tjetër ekonomike dhe ajo bashkëkohore Postkejniane
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	- Analiza bashkëkohore mikro-ekonomike

	Postmarshalliane Përfaqësuesit e kembrixhit amerikan
Java e dymbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Mundësitë e prodhimit dhe problemet themelore të tyre - Efikasiteti i shpërndarjes së faktorëve të prodhimit
Java e trembëdhjetë:	Niveli i prodhimit global dhe inkuadrimit – stabiliteti i çmimeve <ul style="list-style-type: none"> - Konsumi dhe Kursimi - Kursimi dhe investimet
Java e katërbëdhjetë:	Mosinkuadrimi, inflacioni, deflacioni dhe principi i akceleracionit <ul style="list-style-type: none"> - Paradoksi i kursimit - Papunësia dhe "gap-i i inflacionit"
Java e pesëmbëdhjetë:	Mekanizmi i tregut dhe problemet aktuale ekonomike Veprimi i mekanizmit të tregut Teoritë ekonomike

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<ul style="list-style-type: none"> - Studentet duhet të respektojnë orarin e ligjeratave, ushtrimeve dhe të jenë të vëmendshëm gjatë orës mësimore.